



KUVENDI KOMUNAL PEJË

I. Numër: 060/01-6288, datë: 31. Janar 2019.

Në bazë të nenit 12.pika 2 (c), të Ligjit Nr.03/L – 040 për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës datë: 04.Qershor 2008 (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28 datë: 04.qershor 2008”) nenit 20 alinea 1, pika 4 dhe nenit 22 alinea 2. pika d) të Statutit të Komunes së Pejës, 01.Numër: 09 – 8103 datë 29.09.2008, Kuvendi Komunal Pejë, në takimin e mbajtur me datë:31. Janar 2019, pas shqyrtimit të Draft – Rregullores Nr. __/2019, për kushtet dhe kriteret për ushtrimin e veprimtarisë së transportit Taxi të udhëtarëve në Komunën e Pejës, në Rekomandim të KPF-ca, muarr:

V E N D I M

Nr.05/ 2019

**MBI MIRATIMIN NË PARIM DHE DHËNJEN NË DISKUTIM PUBLIK TË
Draft – Rregullores Nr. __/2019 për kushtet dhe kriteret për ushtrimin e
Veprimtarisë së transportit Taxi të udhëtarëve, në Komunën e Pejës**

I. IPET në Diskutim Publik: **Draft – Rregullorja Nr. __/2019 për kushtet dhe kriteret për ushtrimin e veprimtarisë së transportit Taxi të udhëtarëve, në Komunën e Pejës**

II.Diskutimi Publik zgjat 14 ditë, nga dita e shpalljes – paraqitjes së Draft – Rregullorës në Tabellen e shpalljeve publike dhe në Ueb faqen zyrtare të KK.Pejë.

III. Qytetarët e Interesuar mund të njoftohen me tekstin – përmbajtjen e Draft – Rregullorës të lartë cekur, përmes Drejtorisë për Zhvillim Ekonomik të KK.Pejë.

IV. Vërejtjet dhe sugjerimet eventuale në Draft – Rregullorën e lartëcekur, mund të bëhen me shkrim dhe të dorëzohen përmes Zyrës së pranimit – Arkives, për Drejtorinë për Zhvillim Ekonomik të KK.Pejë.

V.Vërejtjet dhe sugjerimet duhet të paraqiten vetëm me shkrim dhe në kohën e afatit caktuar me këtë vendim, ngase vërejtjet e paraqitura jashtë afatit nuk do të mirrën parasysh.



KRYESUESI,
Dr.Islam Husaj